

Z.Pavlin Ndreu, mban pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme Detare që nga muaji Prill 2018. Ndërsa, më parë, në vitin 2014-2018 ka mbajtur postin e Zv.Drejtor i Përgjithshëm dhe Kapiten i Porteve në DPDetare detyrë e cila e ka angazhuar me drejtimin , organizimin e Kapitenerive të Porteve, të Sektorit të QNOD dhe Sektorit të KSHP- së për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me respektimin e disiplinës portuale të trafikut detar, garantimin e sigurisë së mjeteve në porte dhe në rada, në zbatimin e ligjshmërisë detare;. Nga viti 1995 - 2013 Ka menaxhuar në cilësi të administratorit Shoqërinë N.S.S shpk e profilizuar në fushën e shërbimit të ruajtjes së sigurisë fizike dhe mbrojtjes së jetës në objekte shtetërore dhe private. Është diplomuar Master Shkencor si Komandues Detar pranë Akademisë së Detarisë në Vlorë .Z. Ndreu ka marrë pjesë në trajnime në fusha të ndryshme si brenda dhe jashtë vendit.